



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI

Nr. 1631/ prot.
3

Pogradec, më 18.09.2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj.MANJOLLA KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues etj, për: **Miratimin e listës së Fondit Kullosor, që mund të jepen me qera, për kullotje e kositje bari, me sipërfaqe prej 1512,75 ha, në Ekonomitë Kullosore; "Golik-Kalivaç", "Vërri-Debrovë", "Pretushë-Lin", "Guri Top-Gjemth", "Dunicë-Llëngë" Dhe "Niçë-Valamarë", dhe kontratës Tip .**

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues të projekt vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacionit teknik shpjegues: 4

Nr. i fletëve A4 kontratë tip 5

Nr. i faqeve A4 lista e inventarit të kullotave dhe listë inventari: 12



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____, _____. 2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ DATË _____, _____. 2025

PËR

**MIRATIMIN E, LISTËS SË FONDIT KULLOSOR, QË MUND TË JEPEN ME QERA,
PËR KULLOTJE E KOSITJE BARI, ME SIPËRFAQE PREJ 1512,75 HA, NË
EKONOMITË KULLOSORE; "GOLIK-KALIVAÇ", "VËRRI-DEBROVË",
"PRETUSHË-LIN", "GURI TOP-GJEMTH", "DUNICË-LLËNGË" DHE "NIÇË-
VALAMARË", DHE KONTRATËS TIP .**

Në mbështetje të; nenit 8, shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, shkronjës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 15 të Ligjit Nr.9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kulllosor", i ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime ne vendimin Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e bashkive", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.632, datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje" si dhe të Udhëzimit Nr. 2, datë 20.07.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", me propozim të Kryetarit të bashkisë, Këshilli i bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e fondit kulllosor, që mund të jepen me qera, për kullotje e kositje bari, me sipërfaqe prej 1512,75 Ha, të ndodhura në ekonomitë kulllosore; "Golik - Kalivaç", "Vërri - Debrovë", "Pretushë - Lin", "Guri Top - Gjemth", "Dunicë - Llëngë" dhe "Niçë - Valamarë", bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
2. Të miratojë kontratën TIP të qerasë, për dhënien e kullotave, për kullotje e kositje bari, për një periudhë 1-3 vjecare, sipas tekstit lidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërse e tij.



3. Për vazhdimin e procedurave të parashikuara nga Udhëzimi Nr.2, datë 20.07.2016 të Ministrit të Mjedisit të ngarkohet Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike pranë bashkisë Pogradec dhe për nënshkrimin e kontratës autorizohet Drejtori i saj.
4. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.
5. U shpall sot më datë __.04.2025

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI

Nr. 163/1 Prot.

Pogradec, më 18.04, 2025

RELACION PËR PROJEKT- VENDIMIN
ME OBJEKT:

"PËR

MIRATIMIN E, LISTËS SË FONDIT KULLOSOR, QË MUND TË JEPEN ME QERA, PËR KULLOTJE E KOSITJE BARI, ME SIPËRFAQE PREJ 1512,75 HA, NË EKONOMITËKULLOSORE;"GOLIK-KALIVAC","VËRRI DEBROVË","PRETUSHË-LIN", "GURI TOP-GJEMTH", "DUNICË-LLËNGË" DHE "NIÇË-VALAMARË", DHE KONTRATËS TIP .

E NDERUAR KRYETARE E KËSHILLIT!
TË NDERUAR KËSHILLTARË!

KREU I

HYRJA DHE PËRSHKRIMI I VEPRIMTARISË

Ndër të tjera, pranë Bashkisë Pogradec është e krijuar dhe funksionon *Agjencia e Mbrojtjes së Territorit* ku në mbrendësi të saj ka *Inspektoriatin e Shërbimit Kontrollit dhe Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave*, në të cilën janë të përqëndruara pothuajse të gjitha funksionet e deleguara nga Pushteti Qëndror, të cilat janë:

1. *Shërbimi Pyjor.*
2. *Inspektoriatin e Pyjeve*
3. *Spektori i Kullotave.*

Administrimi i i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Pogradec është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **"Funksionet e Bashkive në fushën e buqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit: Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.**

KREU II
INTERPRETIMI I BAZËS LIGJORE



Referuar pikës 5 të nenit 27 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

5.Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Procedura ligjore mbështet në Ligjin Nr.57/2020 "Për Pyjet"; nenit 8, shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, shkronjës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 15 të Ligjit Nr.9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullësor", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në vendimin Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e bashkive", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.632, datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje" si dhe të Udhëzimit Nr. 2, datë 20.07.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", me propozim të Kryetarit të bashkisë, Këshilli i bashkisë,

Mbështetur në legjislacionin pyjor në fuqi për pyjet, tregues për gjëndjen e fondit pyjor/kullësor realizohet vetëm nëpërmjet hartimit të dokumentave për kullotat, në rastin konkretë, hartimin dhe analizim e të dhënave dhe vijimin dhe shfrytëzimin e sipërfaqeve për makzimizimin e të ardhurave nga fondi pyjor/kullësor.

Per sa me sipër, duke krijuar bindjen që projekt vendimi është në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore dhe se dokumentacioni shoqëruar është i plotë, Jini të lutur të miratoni projekt vendimin bashkëngjitur.

Duke shprehur në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptoi: JURIST

ARDI SEITLLARI

Pranoi: KRYEINSPEKTOR

KLEDI LUFO

Miratoi: DREJTORI I AMT

MARKEL HAFESLLARI

Konfirmoi: KRYETAR

ILIR XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
AGJENCIA E MBROJTJES SË TERRITORIT
Inspektoriati i Shërbimit Kontrollit dhe Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave
(Sektori i Kullotave)

Nr. 8631/13 Prot.

Pogradec, më 18.09, 2025

RELACION

MBI

**MIRATIMIN E LISTËS SË FONDIT KULLOSOR, QË MUND TË JEPEN ME QERA
PËR KULLOTJE E KOSITJE BARI, ME NJË SIPËRFAQE PREJ 1512 HA, NË
EKONOMITË KULLOSORE "GOLIK-KALIVAC", "VËRRI-DEBROVË",
"PRETUSHË-LIN", "GURI TOP-GJEMTH", "DUNICË-LLENGË" DHE "NIÇË-
VALAMARË"**

Në mbështetje të; nenit 8, shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, shkronjës "e" të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 15 të Ligjit Nr.9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullor", i ndryshuar, VKM nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e bashkive", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.632, datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje" si dhe të Udhëzimit Nr. 2, datë 20.07.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënie e tyre për kullotje e kositje bari", Sipërfaqet kullimore sipas ekonomive kullimore që janë në pronësi të bashkisë do të jepen me qera për kullotje të blegtorisë, mbasi lista të miratohet në Këshillin Bashkiak.

Dhënia e kullotave me qera ose përdorim për kullotje e kositje bari do t'iu nënshtrohen rregulave dhe parimeve të mëposhtme:

1. Kullotat dhe livadhet në pronësi të bashkisë do të jepen në përdorim ose qera, për kullotjen e bagëtive ose për kositje të barit, përkundrejt tarifave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Ato do tu jepet personave fizikë e juridikë për një periudhë kohe 1 deri në 3 vjet.
3. Dhënia në përdorim për kullotje bëhet në përputhje me aftësitë mbajtëse kullimore, të përcaktuara në planin e mbarrështimit për çdo ngastër ose nën-ngastër.

4. Dhënia për kullotje e kullotave dhe e livadheve, do të bëhet në bazë të një kontrate, që lidhet ndërmjet strukturës përgjegjëse përkatëse për pyjet dhe kullotat në bashki dhe kërkuesit.

5. Personi fizik ose juridik, që ka marrë kullotë apo livadh për kullotje ose kositje, nuk mund ta japë atë apo pjesë të saj tek të tretë me nënkontratë.

Thëksojmë se dhënia e ketyre sipërfaqeve kullimore në përdorim nuk çënon kullotat për tufëzat e vogëla apo gjedhet për nevoja familjare të banuesve në fshat, pasi këto sipërfaqe ndodhen larg fshatrave të banuar.

Gjithashtu, Dhënia e kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive e për kositje bari, sipas listes bashkëngjitur, do të bëhet sipas treguesve teknikë të planeve të mbarështimit të kullotave, pasi këto plane janë miratuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për fondin kullor dhe plotësojnë, në përputhje me ligjin e lartpërmendur masat, për:

- I) ruajtjen e ekosistemeve natyrore kullimore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve kullimore;
- II) ruajtjen dhe nxitjen e aftësive prodhuese të kullotave e livadheve;
- III) zbatimin e mënyrave të mbarështimit të kullotave, në mënyrë të veçantë për parandalimin e zjarreve, gërryerjes dhe të degradimit të tokës;
- IV) ruajtjen e mbulesës barishtore nga mbikullotja dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, veçanërisht asaj ujëmbajtëse.

Në territorin administrativ të bashkisë Pogradec sipërfaqet kullimore shtrihen në shtatë ekonomi kullimore, këto ekonomi janë të përputhura afërsisht me njësitë administrative, dhe ekonomitë pyjore.

- ✓ Këto ekonomi kanë një sipërfaqe prej 2463.97 ha, kullota në ekonomi kullimore dhe kullota me sipërfaqe të vogla brenda fondit pyjor pra brenda ekonomive pyjore janë 1380.58 ha, **në total 3883.5 ha kullota.**
- ✓ Nga ky total sipas "Listes së kullotave në pronësi të Bashkisë Pogradec e gatshme për kullotje kositje bari" është parashikuar që të jepen në përdorim sipërfaqja prej 1512.75 ha ndërsa pjesa tjetër ti lihet fshatërisë për përdorim.

Ekonomitë kullimore dhe ngastrat që janë propozuar për tu dhënë me qera për kullotje e kositje bari janë si më poshtë:

- ✓ Ekonomia kullimore **Golik-Kalivac**, që shtrihet brenda ekonomisë pyjore Mokër I, nga fshati Golik deri në qafën e Lipovës, Kalivac me një sipërfaqe prej **109.7 ha** dhe kapacitet mbajtës **327 krerë dhen**. Në këtë ekonomi janë parashikuar këto ngastra (Shih listën) të cilat kanë një kapacitet kullor mbajtës prej **3 krerë/ha**. Ngastrat e tjera të kësaj ekonomie që kanë kapacitet të ulët kullor do të përdoren për kullotje nga komuniteti nga tufat me numur krerësh të vogël.
- ✓ Ekonomia kullimore **Vërri-Debrovë** janë parashikuar 11 parcela me një sipërfaqe prej **472 ha** dhe kapacitet mbajtës në krer prej **1249 krerë, pra 2.5-3 krerë/ha.**
- ✓ Kjo ekonomi shtrihet pjesërisht në njësinë Administrative Proptisht, Vërri- deri në Slabinjë, dhe njësinë administrative Velçan, duke hequr fshatrat Bishnicë, Shpellë, Jollë.

- ✓ Ekonomia kullosore **Pretushe-Lin** ka dy ngastra 11b dhe 12b që i perkasin njesise Administrative Proptisht me nje siperfaqe prej **185 ha** dhe kapacitet mbajtës prej **458 krere dhen, per ha/2.5 krere**. Kullosin blegtoria e fshatrave Rodokal dhe Homezh.
- ✓ Ekonomia kullosore **Guri Top-Gjemth**, është ekonomia kullosore me e rëndësishme e cila ka një sipërfaqe prej **633 ha** dhe kapacitet mbajtës prej **2902 krere dhen**, ka ne perberje 16 parcela te cilat per çdo vit leshohen e qera per kullotje, kapacitet mbajtës për **ha është rreth 4.6 krere dhen**.
- ✓ Kjo ekonomi shtrihet gjatë kufirit ndarës ndermjet bashkisë Pogradec dhe bashkisë Gramsh, Maja e Gurit Top deri në Majën e Gurit të zi mbi Bishnicë, ku ndan kufiri me bashkinë Librazhd. Në këtë ekonomi kullosin blegtoria e ardhur kryesisht nga rrethi i Gramshit dhe pak nga Pogradeci.
- ✓ Në ekonominë kullosore **Dunicë-Llëngë** mendohet të lëshohen me qera dy ngastra 7a dhe 10a me një sipërfaqe prej **21 ha** dhe kapacitet mbajtës **64 krere, kanë 3 krer /ha** kapacitein, ngastrat e tjera do të përdoren për kullotje nga komuniteti me tufat e vogla të fshatrave, shtrihet nga fshati Guri bardhë dhe deri në fshatin Hondisht.
- ✓ Ekonomia kullosore **Niçë-Valamarë** do të përdoren për kullotje 6 parcela kullosore, (ngastratat e tjera janë në zonë të mbrojtur Guri i Nikës) ka nje siperfaqe prej **80.5 ha dhe nje kapacitet mbajtës prej 800krere** dhen, jane kullota me kapacitet te larte krere per ha **8-10krerë**. Në këtë ekonomi nuk janë futur ngastrat 1,2,3 ,4,5 që ndodhen në afërsi të fshatit osnat dhe Niçë, kanë kapacitet të ulet mbajtës, janë kullotat rreth Gurit të Kamjes do të përdoren per kullotje nga bagëtia e fshatit.
- ✓ Sipas udhëzimit nr.2 date 20.07.2016, pika 6, kërkesat për marrjen e kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive, paraqiten në strukturën përgjegjëse të pyjeve, të cilat i shqyrtojnë dhe i miratojnë nga një komision i veçantë i miratuar nga Kryetari Bashkisë, për çdo subjekt në veçanti merret një vendim nga kryetari i komisionit.

Procedurat e dhënies në përdorim të përkohshem me kontrate qiraje të kullotave sipas pikës 7 referohen sipas afateve:

-Deri në tre vjet, për kullotjen e bagëtive, zbatohen nga Drejtoritë përkatëse të Shërbimit Pyjor dhe sektorit të kullotave në Bashki.

-Deri në 10 vjet, për kullotjen e bagëtive, kontrata e qerasë lidhet pasi të jetë marrë miratimi paraprak nga këshilli bashkiak dhe kontrata e qerasë bëhet me akt noterial.

- Në listën e ngastrave kullosore që dotë miratohen për dhënie me qera, nuk janë llogaritur pyjete ulet të lisit dhe pjeserisht të ahut, që kullotën nga nga blegtoria e fshatrave përreth tyre sidomos dhija që zë një numur të konsiderushem të krerëve që kullosin. Si përfundim tufat e bagëtive që kanë fshatarët (mbi 50 krerë) nuk do të lidhet kontratë por pagesa për krerë do të bëhet pranë Njësive Administrative, sipas VKM nr. 632 datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave për kullotje e kositje bari", kullotjen në pyll.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,



PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptuan:

**SPECIALIST
PËRGJEGJËS SEKTORI**

**Eugen BERBERI
Arian MINGA**

Pranoi:

KRYEINSPEKTOR I PYJEVE

Ing.Kledi LUFO

Miratoi:

DREJTORI AMT

Markel HAFESLLARI

Konfirmoi:

KRYETAR

ILIR XHAKOLLI

BASHKIA POGRADEC							
LISTA E INVENTARIT TË KULLOTAVE SIPAS VKM NR.398 DATË 13.05.2020							
NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË POGRADEC							
Nr.	Qarku	Bashkia	Kodi kadastral	Ekonomia pyjore/ kullosore	Ngastra/ nëngastra	Sipërfaqja ha	Kategoria e përdorimit të territorit
0	1	2	3	4	5	6	7
1	Korçë	Pogradec	KO04 0 001	Dunice-Llëngë	1	14.28	Kullotë
2	Korçë	Pogradec	KO04 0 002	Dunice-Llëngë	2	14.38	Kullotë
3	Korçë	Pogradec	KO04 0 003	Dunice-Llëngë	3	55.97	Kullotë
4	Korçë	Pogradec	KO04 0 004	Dunice-Llëngë	4	32.75	Kullotë
5	Korçë	Pogradec	KO04 0 005	Dunice-Llëngë	5	63.59	Kullotë
6	Korçë	Pogradec	KO04 0 006	Dunice-Llëngë	6	28.7	Kullotë
7	Korçë	Pogradec	KO04 0 007	Dunice-Llëngë	7	53	Kullotë
8	Korçë	Pogradec	KO04 0 008	Dunice-Llëngë	8	68.8	Kullotë
9	Korçë	Pogradec	KO04 0 009	Dunice-Llëngë	9	4.3	Kullotë
10	Korçë	Pogradec	KO04 0 010	Dunice-Llëngë	10	3.9	Kullotë
11	Korçë	Pogradec	KO05 0 001	Golik-Kalivaç	1	6.38	Kullotë
12	Korçë	Pogradec	KO05 0 002	Golik-Kalivaç	2	23.4	Kullotë
13	Korçë	Pogradec	KO05 0 003	Golik-Kalivaç	3	1.23	Kullotë
14	Korçë	Pogradec	KO05 0 004	Golik-Kalivaç	4	7.98	Kullotë
15	Korçë	Pogradec	KO05 0 007	Golik-Kalivaç	7	18.25	Kullotë
16	Korçë	Pogradec	KO05 0 009	Golik-Kalivaç	9	2.83	Kullotë
17	Korçë	Pogradec	KO05 0 010	Golik-Kalivaç	10	39.19	Kullotë
18	Korçë	Pogradec	KO05 0 011	Golik-Kalivaç	11	77.47	Kullotë
19	Korçë	Pogradec	KO05 0 014	Golik-Kalivaç	14	49.22	Kullotë
20	Korçë	Pogradec	KO05 0 015	Golik-Kalivaç	15	3.2	Kullotë
21	Korçë	Pogradec	KO05 0 016	Golik-Kalivaç	16	1.16	Kullotë
22	Korçë	Pogradec	KO05 0 017	Golik-Kalivaç	17	18.16	Kullotë
23	Korçë	Pogradec	KO05 0 018	Golik-Kalivaç	18	28.26	Kullotë
24	Korçë	Pogradec	KO07 0 001	Guri Top-Gjemth	1	51.81	Kullotë





25	Korçë	Pogradec	KO07 0 001/1	Guri Top-Gjemth	1,1	15,34	Kullotë
26	Korçë	Pogradec	KO07 0 002	Guri Top-Gjemth	2	38,57	Kullotë
27	Korçë	Pogradec	KO07 0 003	Guri Top-Gjemth	3	72,62	Kullotë
28	Korçë	Pogradec	KO07 0 004	Guri Top-Gjemth	4	42,97	Kullotë
29	Korçë	Pogradec	KO07 0 005	Guri Top-Gjemth	5	16,06	Kullotë
30	Korçë	Pogradec	KO07 0 006	Guri Top-Gjemth	6	36,29	Kullotë
31	Korçë	Pogradec	KO07 0 006/1	Guri Top-Gjemth	6,1	15,34	Kullotë
32	Korçë	Pogradec	KO07 0 007	Guri Top-Gjemth	7	23,99	Kullotë
33	Korçë	Pogradec	KO07 0 008	Guri Top-Gjemth	8	21,76	Kullotë
34	Korçë	Pogradec	KO07 0 009	Guri Top-Gjemth	9	28,67	Kullotë
35	Korçë	Pogradec	KO07 0 010	Guri Top-Gjemth	10	24,54	Kullotë
36	Korçë	Pogradec	KO07 0 011	Guri Top-Gjemth	11	38,37	Kullotë
37	Korçë	Pogradec	KO07 0 012	Guri Top-Gjemth	12	1,67	Kullotë
38	Korçë	Pogradec	KO07 0 014	Guri Top-Gjemth	14	53,31	Kullotë
39	Korçë	Pogradec	KO07 0 015	Guri Top-Gjemth	15	21,87	Kullotë
40	Korçë	Pogradec	KO07 0 016	Guri Top-Gjemth	16	94	Kullotë
41	Korçë	Pogradec	KO12 0 041	Mali - Thatë	41	53,3	Kullotë
42	Korçë	Pogradec	KO15 0 001	Niçë-Valamarë	1	55,3	Kullotë
43	Korçë	Pogradec	KO15 0 002	Niçë-Valamarë	2	45,8	Kullotë
44	Korçë	Pogradec	KO15 0 003	Niçë-Valamarë	3	79,8	Kullotë
45	Korçë	Pogradec	KO15 0 004	Niçë-Valamarë	4	43,3	Kullotë
46	Korçë	Pogradec	KO15 0 006	Niçë-Valamarë	6	8,2	Kullotë
47	Korçë	Pogradec	KO15 0 007	Niçë-Valamarë	7	76,48	Kullotë
48	Korçë	Pogradec	KO15 0 008	Niçë-Valamarë	8	76,92	Kullotë
49	Korçë	Pogradec	KO15 0 009	Niçë-Valamarë	9	13,24	Kullotë
50	Korçë	Pogradec	KO15 0 018	Niçë-Valamarë	18	123,34	Kullotë
51	Korçë	Pogradec	KO17 0 001	Pretushë-Lin	1	9,7	Kullotë
52	Korçë	Pogradec	KO17 0 002	Pretushë-Lin	2	12,8	Kullotë
53	Korçë	Pogradec	KO17 0 004	Pretushë-Lin	4	5,2	Kullotë
54	Korçë	Pogradec	KO17 0 005	Pretushë-Lin	5	76,25	Kullotë
55	Korçë	Pogradec	KO17 0 005/1	Pretushë-Lin	5,1	7,19	Kullotë

56	Korçë	Pogradec	KO17 0 006	Pretushë-Lin	6	47.7	Kullotë
57	Korçë	Pogradec	KO17 0 006	Pretushë-Lin	6.1	43.3	Kullotë
58	Korçë	Pogradec	KO17 0 011	Pretushë-Lin	11k	56.24	Kullotë
59	Korçë	Pogradec	KO17 0 012	Pretushë-Lin	12k	49.74	Kullotë
60	Korçë	Pogradec	KO17 0 011	Pretushë-Lin	11b	56.24	Kullotë
61	Korçë	Pogradec	KO17 0 012	Pretushë-Lin	12b	47.47	Kullotë
62	Korçë	Pogradec	KO23 0 001	Vërri-Debrovë	1	35.54	Kullotë
63	Korçë	Pogradec	KO23 0 004	Vërri-Debrovë	4	40.12	Kullotë
64	Korçë	Pogradec	KO23 0 005	Vërri-Debrovë	5	11.6	Kullotë
65	Korçë	Pogradec	KO23 0 006	Vërri-Debrovë	6	4.01	Kullotë
66	Korçë	Pogradec	KO23 0 007	Vërri-Debrovë	7	18.34	Kullotë
67	Korçë	Pogradec	KO23 0 009	Vërri-Debrovë	9	8.1	Kullotë
68	Korçë	Pogradec	KO23 0 010	Vërri-Debrovë	10	92.89	Kullotë
69	Korçë	Pogradec	KO23 0 012	Vërri-Debrovë	12	11.47	Kullotë
70	Korçë	Pogradec	KO23 0 013	Vërri-Debrovë	13	31.62	Kullotë
71	Korçë	Pogradec	KO23 0 015	Vërri-Debrovë	15	9.19	Kullotë
72	Korçë	Pogradec	KO26 0 074b	Alarup	74b	30.6	Kullotë
74	Korçë	Pogradec	KO26 0 075b	Alarup	75b	29.12	Kullotë
77	Korçë	Pogradec	KO26 0 077d	Alarup	76d	71.57	Kullotë
78	Korçë	Pogradec	KO26 0 087b2	Alarup	87b2	8.59	Kullotë
79	Korçë	Pogradec	KO26 0 088b	Alarup	88b	3.1	Kullotë
80	Korçë	Pogradec	KO26 0 088b1	Alarup	88b1	1.8	Kullotë
81	Korçë	Pogradec	KO29 1 018b	Bishnicë(Pj. Ek. Bishnicë)	18b	9.86	Kullotë
82	Korçë	Pogradec	KO29 1 018c	Bishnicë(Pj. Ek. Bishnicë)	18c	1.85	Kullotë
83	Korçë	Pogradec	KO29 2 002b	Bishnicë(Pj. Ek. Talle)	2b	34.87	kullote
84	Korçë	Pogradec	KO29 2 009b	Bishnicë(Pj. Ek. Talle)	9b	17.98	Kullotë
85	Korçë	Pogradec	KO29 2 010b	Bishnicë(Pj. Ek. Talle)	10b	9.9	Kullotë
86	Korçë	Pogradec	KO29 2 018c	Bishnicë(Pj. Ek. Talle)	18c	13.8	Kullote
87	Korçë	Pogradec	KO29 2 025b	Bishnicë(Pj. Ek. Talle)	25b	10.13	Kullotë
88	Korçë	Pogradec	KO29 2 027d	Bishnicë(Pj. Ek. Talle)	27d	1.72	Kullotë
89	Korçë	Pogradec	KO29 2 032c	Bishnicë(Pj. Ek. Talle)	32c	3.18	kullote



90	Korçë	Pogradec	KO29 2 034b1	Bishnicë(P.Ek. Tallë)	34b1	1.23	kullote
91	Korçë	Pogradec	KO29 2 034b2	Bishnicë(P.Ek. Tallë)	34b2	0.83	kullote
92	Korçë	Pogradec	KO29 2 034b3	Bishnicë(P.Ek. Tallë)	34b3	1.52	kullote
93	Korçë	Pogradec	KO29 3 003k	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	3k	22.48	Kullotë
94	Korçë	Pogradec	KO29 3 004c	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	4c	3.9	Kullotë
95	Korçë	Pogradec	KO29 3 005e	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	5e	6.23	Kullotë
96	Korçë	Pogradec	KO29 3 007b	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	7b	6.95	Kullotë
97	Korçë	Pogradec	KO29 3 010a	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	10a	4.06	Kullotë
98	Korçë	Pogradec	KO29 3 013c	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	13c	1.99	Kullotë
99	Korçë	Pogradec	KO29 3 015b	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	15b	49.25	Kullotë
100	Korçë	Pogradec	KO29 3 015e	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	15e	23.4	kullote
101	Korçë	Pogradec	KO29 3 016b	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	16b	6	Kullotë
102	Korçë	Pogradec	KO29 3 024c	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	24c	7	Kullotë
103	Korçë	Pogradec	KO29 3 025b	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	25b	24.6	kullote
104	Korçë	Pogradec	KO29 3 026b1	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	26b1	1.37	Kullote
105	Korçë	Pogradec	KO29 3 033e	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	33e	30.4	kullote
106	Korçë	Pogradec	KO29 3 036b	Bishnicë(P.Ek.U. Ftohë)	36b	13.87	Kullote
107	Korçë	Pogradec	KO33 0 010a	Dardhas-Pretushë	10b3	0.62	Kullote
108	Korçë	Pogradec	KO33 0 014b	Dardhas-Pretushë	14b	1	kullote
109	Korçë	Pogradec	KO35 0 010b	Dunice-Çezmë	10b	2.04	kullote
110	Korçë	Pogradec	KO35 0 010b1	Dunice-Çezmë	10b1	1.8	kullote
111	Korçë	Pogradec	KO35 0 012a	Dunice-Çezmë	12a	8.54	kullote
112	Korçë	Pogradec	KO35 0 012b1	Dunice-Çezmë	12b1	9.23	kullote
113	Korçë	Pogradec	KO35 0 012k	Dunice-Çezmë	12k	3.17	kullote
114	Korçë	Pogradec	KO35 0 012k1	Dunice-Çezmë	12k1	2.8	kullote
115	Korçë	Pogradec	KO35 0 014b	Dunice-Çezmë	14b	0.52	kullote
116	Korçë	Pogradec	KO35 0 016b	Dunice-Çezmë	16b	3.46	kullote
117	Korçë	Pogradec	KO35 0 024b	Dunice-Çezmë	24b	2.19	kullote
118	Korçë	Pogradec	KO40 0 002b	Guri i Nikes	2b	17.8	Kullote
119	Korçë	Pogradec	KO40 0 003b	Guri i Nikes	3b	17.91	Kullote
120	Korçë	Pogradec	KO40 0 004b	Guri i Nikes	4b	3.08	Kullote

121	Korçë	Pogradec	KO40 0 005b	Guri i Nikes	5b	5.68	Kullote
122	Korçë	Pogradec	KO40 0 005c	Guri i Nikes	5c	5.68	Kullote
123	Korçë	Pogradec	KO40 0 006b	Guri i Nikes	6b	7.7	Kullote
124	Korçë	Pogradec	KO40 0 007b	Guri i Nikes	7b	5.32	Kullote
125	Korçë	Pogradec	KO40 0 007d	Guri i Nikes	7d	0.45	Kullote
126	Korçë	Pogradec	KO40 0 008b	Guri i Nikes	8b	1.04	Kullote
127	Korçë	Pogradec	KO40 0 008d	Guri i Nikes	8d	8	Kullote
128	Korçë	Pogradec	KO40 0 009b	Guri i Nikes	9b	2.6	Kullote
129	Korçë	Pogradec	KO40 0 010b	Guri i Nikes	10b	4.97	Kullote
130	Korçë	Pogradec	KO40 0 011b	Guri i Nikes	11b	28.03	Kullote
131	Korçë	Pogradec	KO40 0 011e	Guri i Nikes	11e	14	Kullote
132	Korçë	Pogradec	KO40 0 012b	Guri i Nikes	12b	1.12	Kullote
133	Korçë	Pogradec	KO40 0 013b	Guri i Nikes	13b	1.49	Kullote
134	Korçë	Pogradec	KO40 0 013e	Guri i Nikes	13e	2.69	Kullote
135	Korçë	Pogradec	KO40 0 013f	Guri i Nikes	13f	2.15	Kullote
136	Korçë	Pogradec	KO40 0 014b	Guri i Nikes	14b	0.89	Kullote
137	Korçë	Pogradec	KO40 0 014d	Guri i Nikes	14d	4.79	Kullote
138	Korçë	Pogradec	KO40 0 015b	Guri i Nikes	15b	2.75	Kullote
139	Korçë	Pogradec	KO40 0 015d	Guri i Nikes	15d	0.65	Kullote
140	Korçë	Pogradec	KO40 0 016b	Guri i Nikes	16b	7.67	Kullote
141	Korçë	Pogradec	KO40 0 016d	Guri i Nikes	16d	9.58	Kullote
142	Korçë	Pogradec	KO40 0 016e	Guri i Nikes	16e	0.96	Kullote
143	Korçë	Pogradec	KO40 0 018b	Guri i Nikes	18b	7.98	Kullote
144	Korçë	Pogradec	KO40 0 018d	Guri i Nikes	18d	2.73	Kullote
145	Korçë	Pogradec	KO40 0 019b	Guri i Nikes	19b	4.8	Kullote
146	Korçë	Pogradec	KO40 0 020b	Guri i Nikes	20a	2.95	Kullote
147	Korçë	Pogradec	KO40 0 021b	Guri i Nikes	21b	8.91	kullote
148	Korçë	Pogradec	KO40 0 023b	Guri i Nikes	23b	7.29	Kullote
149	Korçë	Pogradec	KO40 0 023f	Guri i Nikes	23f	1.67	Kullote
150	Korçë	Pogradec	KO40 0 023g	Guri i Nikes	23g	0.25	Kullote
151	Korçë	Pogradec	KO40 0 023i	Guri i Nikes	23i	0.59	Kullote



152	Korçë	Pogradec	KO40 0 024b	Guri i Nikes	24b	3.53	Kullote
153	Korçë	Pogradec	KO40 0 024d	Guri i Nikes	24d	0.33	Kullote
154	Korçë	Pogradec	KO40 0 024f	Guri i Nikes	24f	0.5	Kullote
155	Korçë	Pogradec	KO40 0 025b	Guri i Nikes	25b	1.52	Kullote
156	Korçë	Pogradec	KO40 0 025c	Guri i Nikes	25c	0.89	Kullote
157	Korçë	Pogradec	KO40 0 026b	Guri i Nikes	26b	2.42	Kullote
158	Korçë	Pogradec	KO40 0 027d	Guri i Nikes	27d	1.92	Kullote
159	Korçë	Pogradec	KO40 0 028b	Guri i Nikes	28b	2.64	Kullote
160	Korçë	Pogradec	KO40 0 030b	Guri i Nikes	30b	3.5	Kullote
161	Korçë	Pogradec	KO40 0 031b	Guri i Nikes	31b	2.39	Kullote
162	Korçë	Pogradec	KO40 0 031d	Guri i Nikes	31d	0.79	Kullote
163	Korçë	Pogradec	KO40 0 032b	Guri i Nikes	32b	0.77	Kullote
164	Korçë	Pogradec	KO40 0 034b	Guri i Nikes	34b	1.3	Kullote
165	Korçë	Pogradec	KO40 0 036b	Guri i Nikes	36b	1.48	Kullote
166	Korçë	Pogradec	KO40 0 037b	Guri i Nikes	37b	1.09	kullote
167	Korçë	Pogradec	KO40 0 037c	Guri i Nikes	37c	0.55	Kullote
168	Korçë	Pogradec	KO49 0 009e	Moker 1	9e	20.75	kullote
169	Korçë	Pogradec	KO49 0 012b	Moker 1	12b	1.8	kullote
170	Korçë	Pogradec	KO49 0 015b	Moker 1	15b	1.06	kullote
171	Korçë	Pogradec	KO49 0 015b3	Moker 1	15b3	0.7	kullote
172	Korçë	Pogradec	KO49 0 020b1	Moker 1	20b1	1.77	kullote
173	Korçë	Pogradec	KO49 0 025b5	Moker 1	25b5	1.39	kullote
174	Korçë	Pogradec	KO49 0 027b	Moker 1	27b	74.4	kullote
175	Korçë	Pogradec	KO49 0 027k	Moker 1	27k	47.23	kullote
176	Korçë	Pogradec	KO49 0 030b	Moker 1	30b	1.66	kullote
177	Korçë	Pogradec	KO49 0 036b1	Moker 1	36b1	0.64	kullote
178	Korçë	Pogradec	KO49 0 036b2	Moker 1	36b2	0.6	kullote
179	Korçë	Pogradec	KO49 0 036b3	Moker 1	36b3	0.34	kullote
180	Korçë	Pogradec	KO49 0 037b	Moker 1	37b	20.15	kullote
181	Korçë	Pogradec	KO49 0 044b	Moker 1	44b	2.56	kullote
182	Korçë	Pogradec	KO49 0 046b	Moker 1	46b	0.82	kullote



183	Korçë	Pogradec	KO50 0 012b	Moker 2	12b	3.04	kullote
184	Korçë	Pogradec	KO50 0 012b	Moker 2	12c	32.49	kullote
185	Korçë	Pogradec	KO50 0 012b1	Moker 2	12b1	15.15	kullote
186	Korçë	Pogradec	KO50 0 012b1	Moker 2	12b1	2.25	kullote
187	Korçë	Pogradec	KO50 0 014b	Moker 2	14b	9.97	kullote
188	Korçë	Pogradec	KO50 0 023b	Moker 2	23b	12.33	kullote
189	Korçë	Pogradec	KO50 0 044d	Moker 2	44b	13.5	kullote
190	Korçë	Pogradec	KO57 0 002b	Qafe-Panje	2b	25.25	kullote
191	Korçë	Pogradec	KO57 0 003e	Qafe-Panje	3e	3.48	Kullote
192	Korçë	Pogradec	KO57 0 004b	Qafe-Panje	4b	27.18	Kullote
193	Korçë	Pogradec	KO57 0 004e	Qafe-Panje	4e	6.08	Kullote
194	Korçë	Pogradec	KO57 0 005b	Qafe-Panje	5b	6.27	Kullote
195	Korçë	Pogradec	KO57 0 005d	Qafe-Panje	5d	7.63	Kullote
196	Korçë	Pogradec	KO57 0 006b	Qafe-Panje	6b	4.81	Kullote
197	Korçë	Pogradec	KO57 0 006c	Qafe-Panje	6c	1.87	Kullote
198	Korçë	Pogradec	KO57 0 007b	Qafe-Panje	7b	5.3	Kullote
199	Korçë	Pogradec	KO57 0 008b	Qafe-Panje	8b	5.05	Kullote
200	Korçë	Pogradec	KO40 0 010d	Qafe-Panje	10d	2.61	Kullote
201	Korçë	Pogradec	KO40 0 021c	Qafe-Panje	21c	2.34	kullote
202	Korçë	Pogradec	KO40 0 026c	Qafe-Panje	26c	2.27	Kullotë
203	Korçë	Pogradec	KO40 0 026d	Qafe-Panje	26d	0.93	Kullotë
204	Korçë	Pogradec	KO40 0 027b	Qafe-Panje	27b	0.31	Kullotë
205	Korçë	Pogradec	KO40 0 028b	Qafe-Panje	28b	7.02	Kullotë
206	Korçë	Pogradec	KO40 0 028c	Qafe-Panje	28c	2.77	Kullotë
207	Korçë	Pogradec	KO40 0 029b	Qafe-Panje	29b	8.84	kullote
208	Korçë	Pogradec	KO40 0 029b	Qafe-Panje	29b	8.69	Kullotë
209	Korçë	Pogradec	KO40 0 029d	Qafe-Panje	29d	2.54	Kullotë
210	Korçë	Pogradec	KO40 0 030b	Qafe-Panje	30b	1	Kullotë
211	Korçë	Pogradec	KO40 0 030c	Qafe-Panje	30c	0.6	Kullotë
212	Korçë	Pogradec	KO40 0 030d	Qafe-Panje	30d	1.21	Kullotë
213	Korçë	Pogradec	KO40 0 031b	Qafe-Panje	31b	6.5	Kullotë



214	Korçë	Pogradec	KO40 0 031c	Qafe-Panje	31c	0.99	Kullotë	
215	Korçë	Pogradec	KO40 0 031d	Qafe-Panje	31d	1.32	Kullotë	
216	Korçë	Pogradec	KO40 0 032b	Qafe-Panje	32b	7.95	Kullotë	
217	Korçë	Pogradec	KO40 0 032b1	Qafe-Panje	32b1	0.73	Kullotë	
218	Korçë	Pogradec	KO40 0 032c	Qafe-Panje	32c	2.1	Kullotë	
219	Korçë	Pogradec	KO40 0 033b	Qafe-Panje	33b	8.66	Kullotë	
220	Korçë	Pogradec	KO40 0 034b	Qafe-Panje	34b	1.61	Kullotë	
221	Korçë	Pogradec	KO40 0 038c	Qafe-Panje	38c	0.85	Kullotë	
222	Korçë	Pogradec	KO40 0 039b	Qafe-Panje	39b	4.8	Kullotë	
223	Korçë	Pogradec	KO40 0 042b	Qafe-Panje	42b	1.8	kullote	
224	Korçë	Pogradec	KO40 0 043b	Qafe-Panje	43b	0.92	Kullotë	
225	Korçë	Pogradec	KO40 0 044b	Qafe-Panje	44b	0.9	Kullotë	
226	Korçë	Pogradec	KO40 0 045b	Qafe-Panje	45b	2.9	Kullotë	
227	Korçë	Pogradec	KO40 0 045c	Qafe-Panje	45c	0.66	Kullotë	
228	Korçë	Pogradec	KO44 0 045d	Qafe-Panje	45d	4.76	Kullotë	
229	Korçë	Pogradec	KO44 0 045e	Qafe-Panje	45e	0.94	Kullotë	
230	Korçë	Pogradec	KO44 0 047b	Qafe-Panje	47b	1.48	Kullotë	
231	Korçë	Pogradec	KO44 0 048b	Qafe-Panje	48b	8.51	Kullotë	
232	Korçë	Pogradec	KO44 0 048e	Qafe-Panje	48e	4.05	Kullotë	
234	Korçë	Pogradec	KO44 0 049b	Qafe-Panje	49b	6.75	Kullotë	
235	Korçë	Pogradec	KO44 0 050b	Qafe-Panje	50b	9.47	Kullotë	
236	Korçë	Pogradec	KO44 0 050e	Qafe-Panje	50e	2.07	Kullotë	
237	Korçë	Pogradec	KO44 0 050f	Qafe-Panje	50f	1.73	Kullotë	
238	Korçë	Pogradec	KO44 0 050g	Qafe-Panje	50g	0.79	Kullotë	
239	Korçë	Pogradec	KO44 0 051b	Qafe-Panje	51b	23.48	Kullotë	
240	Korçë	Pogradec	KO44 0 053d	Qafe-Panje	53d	3.67	Kullotë	
241	Korçë	Pogradec	KO44 0 053e	Qafe-Panje	53e	1.46	Kullotë	
242	Korçë	Pogradec	KO62 0 004d	Rrezhan	4d	5.2	kullote	
243	Korçë	Pogradec	KO62 0 005d	Rrezhan	5d	3.21	kullote	
244	Korçë	Pogradec	KO62 0 005e	Rrezhan	5e	12.3	kullote	
245	Korçë	Pogradec	KO62 0 006d	Rrezhan	6d	6.96	kullote	

246	Korçë	Pogradec	KO62 0 006e	Rrezhan	6e	0.96	kullote
247	Korçë	Pogradec	KO62 0 007c	Rrezhan	7d	2.83	kullote
248	Korçë	Pogradec	KO62 0 007e	Rrezhan	7e	1.22	kullote
249	Korçë	Pogradec	KO62 0 008d	Rrezhan	8d	9.05	kullote
250	Korçë	Pogradec	KO62 0 008e	Rrezhan	8e	0.56	kullote
251	Korçë	Pogradec	KO62 0 009d	Rrezhan	9d	25.4	kullote
252	Korçë	Pogradec	KO62 0 009e	Rrezhan	9e	7.79	kullote
253	Korçë	Pogradec	KO62 0 012k	Rrezhan	12k	5.9	kullote
254	Korçë	Pogradec	KO62 0 013b	Rrezhan	13b	10.4	kullote
255	Korçë	Pogradec	KO62 0 015b	Rrezhan	15b	31.2	kullote
256	Korçë	Pogradec	KO62 0 022c	Rrezhan	22c	6.78	kullote
257	Korçë	Pogradec	KO62 0 028k	Rrezhan	28k	12.85	kullote
258	Korçë	Pogradec	KO62 0 029b	Rrezhan	29b	38.6	kullote
						3863.99	

SPECIALISTË E KULLOTAVE

Abidin FRAHOLLI

Eugen BERBERI

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË KULLLOTAVE

Arian MINGA



BASHKIA POGRADEÇ
AGJENCIA E MBROJTJES SË TERRITORIT
INSPEKTORIATI I SHËRBIMIT KONTROLLIT DHE MBROJTJES SË PYJEVE DHE KULLOTAVE
(Sektori i Kullotave)

LISTA E KULLOTAVE NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEÇ TË
GATËSHME PËR KULLOTJE E KOSITJE BARI PËR VITIN 2025

Nr. pasurisë	Ekonomia kullosores	Ngastran/ngastra	Sipërfaqia ha	Kapaciteti krere	Infrastruktura	Lloji kullotës
113	Golik-Kalivaç	1a	5.8	17	E SHFRYTEZUESHME	Verore
114	Golik-Kalivaç	2a	29.4	88	E SHFRYTEZUESHME	Verore
115	Golik-Kalivaç	3a	31.4	94	E SHFRYTEZUESHME	Verore
116	Golik-Kalivaç	4a	10.5	31	E SHFRYTEZUESHME	Verore
117	Golik-Kalivaç	7a	17.8	53	E SHFRYTEZUESHME	Verore
118	Golik-Kalivaç	9a	14.8	44	E SHFRYTEZUESHME	Verore
Shuma:	Golik-Kalivaç		109.7	327		Verore
119	Verri-Debrove	1a	16.6	50	E SHFRYTEZUESHME	Verore
120	Verri-Debrove	5a	17.3	52	E SHFRYTEZUESHME	Verore
121	Verri-Debrove	6a	2.5	5	E SHFRYTEZUESHME	Verore
122	Verri-Debrove	7a	56.7	170	E SHFRYTEZUESHME	Verore
123	Verri-Debrove	9a	8.1	24	E SHFRYTEZUESHME	Verore
371	Verri-Debrove	9a	68.2	204	E SHFRYTEZUESHME	Verore
372	Verri-Debrove	10a	22.5	67	E SHFRYTEZUESHME	Verore
373	Verri-Debrove	12a	85.3	256	E SHFRYTEZUESHME	Verore
374	Verri-Debrove	13a	169	338	E SHFRYTEZUESHME	Verore
375	Verri-Debrove	14a	26.3	53	E SHFRYTEZUESHME	Verore
376	Verri-Debrove	15a	10	30	E SHFRYTEZUESHME	Verore
Shuma:	Verri-Debrove		482.5	1249		Verore



Shuma:	Nicë-Valamare	80.5	800	Verore
Totali:		1512.75	5736	

SPECIALISTË E KULLOTAVE
Abidin FRAHOLLI
Eugen BERBERI

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË KULLLOTAVE
Ardan MINGA

DREJTORI I AMT
Markel HAFESLLARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
AGJENCIA E MBROJTJES SË TERRITORIT
Inspektoriati i Shërbimit Kontrollit dhe Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave
(Sektori i Kullotave)

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ . 2025

KONTRATË QIRAJE Nr. _

PËR

DHËNIEN E KULLOTAVE DHE LIVADHEVE PËR KULLOTJE E KOSITJE BARI

Sot më datën ____ . ____ . 2025, në zbatim të dispozitave të; Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Nenit 15 të Ligjit Nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për Fondin Kullosor", i ndryshuar me Ligjin Nr.49/2016, datë 05/05/2016, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.632, datë 11.06.2009 "Për Miratimin e Tarifave të Përdorimit të Kullotave dhe Livadheve Shtetërore për Kullotje dhe Kositje" si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Mjedisit Nr. 2 datë 20/07/2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënie e tyre për kullotje e kositje bari", lidhet kjo kontratë qiraje ndërmjet:

PALËVE:

1. Agjencia e Mbrojtjes së Territorit, përfaqësuar nga **Z. Markel HAFESLLARI**, cili në këtë kontratë është "**QIRADHËNËSI**" kështu do të quhet edhe më poshtë.

2-Personi juridik/ fizik / fermer, përfaqësuar nga z. _____ më cilësinë e fermerit, i cili në kontratë është "**QIRAMARRËS**" kështu do të quhet edhe më poshtë.



1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS.

Qiradhënësi jep me qira për kullotje/ kositje/ bari/ krasitje gjithë, për ndërtime provizore qiramarrësit z. _____, kullotën verore që ndodhet në ekonominë pyjore _____ në ngastrën Nr. _____ me emër _____ sip _____ ha dhe me kapacitet mbajtës prej _____ kreresh, sipas vendimit nr _____ datë _____, i Ndërmarrjes, Mirëmbajtjes së Infrastruktura dhe Punëve Publike, ngastra kufizohet:

Nga Nr. _____

- Në veri:
- Në jug:
- Në lindje:
- Në perëndim:

NENI 2

AFATI I KONTRATËS.

2.1 Kohëzgjatja e kontratës është 1-3 (një deri në tre) vite.

2.2 Efektet financiare të kësaj kontrate fillojnë nga data e lidhjes së kontratës midis palëve kontraktore.

NENI 3

VLERA VJETORE E QIRASË

3.1 Vlera vjetore e qirasë për përdorimin e kullotave është llogaritur sipas tarifave të miratuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 632, datë 11/06/2009, është si më poshtë:

- Për dhentë krerë - x 50 lekë = - lekë
- Për dhitë krerë - x 80 lekë = - lekë
- Për të trashat krerë _____ x _____ lekë = _____ lekë.

Shuma I : - lekë (-----) lekë

Adresa: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

3.2 Vlera vjetore e qirasë për përdorim e tokës për ndërtim provizore është llogaritur sipas tarifave të miratuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 632 , datë 11/06/2009, si më poshtë:

- Qendër stani e rrethuar, m² _____ x _____ lekë = _____ lekë
- Qendër përpunimi bulmeti, m² _____ x _____ lekë = _____ lekë.
- Ngrehinë banimi për barinj m² _____ x _____ lekë = _____ lekë.
- Mullinj/ Magazina m² _____ x _____ lekë = _____ lekë.

Shuma II: - (-----) lekë

Gjithsej : ----- + ----- = ----- lekë (_____) lekë

NENI 4 PAGESA DHE REGJIMI I QIRASË.

4.1 Pagesa e qirasë bëhet me këste vjetore përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit Nr. 2 datë 20.07.2016, pika 14, dhe do të kryhet pranë bankës të nivelit të dytë, për llogari të Bashkisë Pogradec në cilësinë e qiradhënësit, dhe do të administrohet sipas nenit 27 të Ligjit Nr.9693 , datë 19/03/2007, i ndryshuar me Ligjin Nr.49/2016, datë 05/05/2016.

NENI 5 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

5.1 Qiradhënësi detyrohet t'i dorëzojë qiramarrësit, menjëherë mbas lidhjes së kësaj kontrate hartën e pasurisë me kufijtë e sipërfaqes që do të përdoret për kullotje/ kositje bari/ krasitje gjethi dhe përdorimin e tokës për ndërtimet provizore nga fermeri.

5.2 T'i caktojë në vënd, në rast se ka parcelat që do të përmirsohen dhe parcelat eksperimentale të cilat sipas udhëzimit nuk lejohen të kulloten. Në këto parcela do të mbahen proces-verbale me kufij të qartë.

5.3 T'i dorëzojë qiramarrësit veprat e ujit dhe objektet e tjera në shërbim të kullotës me kapacitetet e plota të tyre.

5.4 Dorëzimi bëhet me Proces-verbal dorëzimi midis subjektit dhe përgjegjësit dhe një inspektori të kullotave të Zyrës së Shërbimit Pyjor Bashkia Pogradec direkt në objekt, mbas nënshkrimit të kësaj kontrate.

5.4 Qiradhënësi ka të drejtë të ushtrojë kontrolle në çdo kohë mbi zbatimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e qiramarrësit dhe mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar në se qiramarrësi respekton detyrimet kontraktore, si dhe ato detyrime që dalin për qiramarrësin sipas natyrës dhe rregullave agroteknike të përdorimit të objektit të kontratës. Në çdo rast kontrolli, qiradhënësi mban në vënd një proce-verbal dhe i kërkon qiramarrësit riparimin e shkeljeve dhe dëmeve të konstatuara.

5.5 Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë me objektin dhe qëllimin e kësaj kontrate.



NENI 6 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

6.1 Mbas nënshkrimit të kësaj kontrate qiramarrësi merr në dorëzim me proce-verbal kullotën/livadhin sipas kufijve të hartës treguese të pasurisë, letrat për ujë të pijshëm për blegtorinë dhe objektet e tjera në shërbim të kullotës. Në rast dëmtimi të tyre, detyrohet t'i riparojë ato pa pagesë.

6.2 Qiramarrësi ka të drejtë të mbajë në kullotë bagëtinë e tij, vetëm sipas aftësisë mbajtëse të kullotës dhe të zbatojë rregullat për përdorimin e kontrolluar të kullotës.

6.3 Qiramarrësi duhet të kryejë pa shpërblim zbrazjen e lerës, (kur ajo është me saraçineskë), pastrimin e saj dhe pastaj të bllokojë rrjedhjet e ujit, për t'u mbushur për sezonin e ardhshëm në prezencë të inspektorit të zonës.

6.4 Të marrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e kullotave nga zjarret.

6.5 Të zbatojë të gjitha rregullat e shërbimit veterinar dhe shëndetsor.

6.6 Të paguajë vlerën e qirasë sipas kësteve të përcaktuar në nenet 3 dhe 4 të kësaj kontratë në datën dhe vendin e caktuar më sipër.

6.7 Të lehtësojë kontrollet që mund të ushtrohen nga institucionet përkatëse të cilat kanë për detyrë të kontrollojnë mënyrën e përdorimit të kullotës së marrë me qira.

6.8 Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me nënqira kullotën apo livadhin objekt të kësaj kontrate, apo t'i kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër juridik ose fizik.

6.9 Në përfundim të afatit kontraktor, qiramarrësi i dorëzon qiradhënësit me proces-verbal dorëzimi të mbajtur direkt në objekt, sipërfaqen objekt të kontratës.

6.10 Në se qiramarrësi ka plotësuar të gjitha detyrimet deri në përfundim të afatit të kontratës, palët bisedojnë për të rishikuar mundësinë e zgjatjes së kontratës deri në lidhjen e një kontrate të re.

NENI 7 ZGJIDHJA E KONTRATËS

7.1 Kontrata zgjidhet me mbarrim të afatit, si dhe me marrëveshje midis palëve.

7.2 Kontrata mund të zgjidhet edhe përpara mbarrimit të saj, vetëm kur janë shkelur dhe nuk janë respektuar kërkesat e saj nga secila palë. Konkretisht, qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate, kur qiramarrësit nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas kushteve të kontratës, dënton ose nuk mirëmban në përdorim, nuk përmbush detyrimet e tjera që rrjedhin nga kontrata. Njoftimi për zgjidhjen e kontratës bëhet me shkrim 15 ditë përpara zgjidhjes së kontratës.

7.3 Për shkeljen e kushteve kontraktore, kur ato janë parashikuar si kundërvajtje administrative sipas nenit 34 të Ligrit Nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor", ndaj qiramarrësit vendosen sanksionet e parashikuara nga ky nen.

7.4 Në rast se kullota digjet, qiramarrësit i humbet e drejta e përdorimit të kullotës për gjithë periudhën e mbetur.

NENI 8 DISPOZITAT E FUNDIT.

8.1 Mosmarrëveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate, zgjidhen me mirëkuptimin e palëve, në mungesë të mirëkuptimit mosmarrëveshjet do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

8.2 Kjo kontratë qitëje hartohet në 3 (tre) kopje, dy prej të cilave : mban qiradhënësi dhe një qiramarrësi i kullotës.

QERAMARRËSI

**QIRADHËNËSI
DREJTORI I AMT**